

UNDEF

The United Nations
Democracy Fund



FNUD

Fonds des Nations Unies
pour la démocratie



**Raport mbi realizimin e
premtimeve elektorale të
zj. Emiriana Sako, Kryetare e
Bashkisë Durrës**

PROJEKTI

**“Ndjekja dhe verifikimi i
premtimeve të fushatës
zgjedhore në Shqipëri”**

Mbështetur nga:

**Fondi për Demokraci i Kombeve të
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorale” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

www.matesielektor.al

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të perealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: rdakorca@gmail.com

Tel: + (355) 822 42626

Premtimet elektorale të zj. Emiriana Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës

1. Rritja e transparencës dhe aksesueshmërisë në shërbimet që do ofrojë Bashkia e Durrësit;
2. Fuqizimi i rinisë dhe grave;
3. Krijimi i sa më shumë hapësirave të gjelbra;
4. Vëmendje e shtuar nga zonave periferike dhe rurale;
5. Investim dhe bashkëpunim nga ana e Bashkisë së Durrësit për projekte të rëndësishme turistike dhe kulturore.

Premtimet e arritura

1. Përfundoi rikonstrukcioni i katër rrugëve, "Xhanfize Keko" dhe rruga e "Vreshtave" në zonën e Spitallës, si dhe "Rrota e kuqe" dhe "Dhimitër Kraja" në plazh.
2. Rikonstrukcioni i rrugës "Ohri" me gjatësi 800 m dhe gjerësi 6 m, në lagjen 15, Nj. Adm. Nr. 6. Ndërhyrja përfshiu asfaltim, sistemim kanalizimesh, trotualet dhe ndriçimin.
3. Rehabilitimi i plotë i rrugës tek varrezat e reja në qytetin e Durrësit.
4. Rehabilitimi i rrugës "Azem Hajdari" në Njësinë Administrative Rrashbull.
5. Rikonstrukcioni i kuartallit dhe rrugës "Prokop M. Gjergo" në zonën e plazhit.
6. Pastrimi dhe sistemimi i kanalit të ujërave të larta në Porto Romano.
7. Rindërtimi i plotë i Qendrës Shëndetësore në Katund Sukth.
8. Rindërtimi total i shkollës "Hasan Koçi" në Durrës.
9. Rindërtimi i shkollës "Njazi Mastori" në Njësinë Administrative Sukth.
10. Rikonstrukcioni i shkollës dhe kopshtit "Vëllezërit Haradinaj" në fshatin Rrashbull, Nj. Adm. Rrashbull.
11. Rikonstrukcioni i rrugës dhe trotuaeve në rrugën "Hazif Podgorica".
12. Rikonstrukcioni total i shkollës "Shaqe Mazreku" në Durrës.
13. Rikonstrukcioni i plotë i rrugës "Kastrioti" në lagjen nr. 8, në Durrës.
14. Rehabilitimi dhe vënia në funksion i rezervuarit në fshatin Arapaj, Nj. Adm. Rrashbull.
15. Rindërtimi total i shkollës "Neim Babameto" në zonën e Spitallës.
16. Rindërtimi i shkollës "Shaqe Mazreku" në Durrës.
17. Rehabilitimi i rrugës "Ahmet Ramzoti" pranë stadiumit "Niko Dovana" në Durrës.
18. Rikonstrukcioni i shkollës dhe kopshtit "Adem Gjeli" në Njësinë Administrative Ishëm.
19. Rehabilitimi i Urës së Bojës në Njësinë Administrative Sukth.
20. Rikonstrukcioni i shkollës dhe kopshtit "Xhelal Shtufi" në Njësinë Administrative Ishëm.
21. Rikonstrukcioni i shkollës 9 – vjeçare "Qemal Mici" në Durrës.
22. Rikonstrukcioni i shëtitores "Taulantia". Ndërhyrja përfshiu krijimin e hapësirave të gjelbra, sistem të ri ndriçimi, kënde sportive dhe hapësira rekreative.
23. Rindërtimi i kopshtit dhe shkollës 9 – vjeçare "Hamallaj" në Njësinë Administrative Sukth.
24. Rindërtimi i kopshtit dhe shkollës 9 – vjeçare "Fshat Rinia" në Njësinë Administrative Katund i Ri.
25. Rikonstrukcioni total i kopshtit "1 Qershori" në Durrës.
26. Rindërtimi i shkollës "Bedrie Bebeziqi" në Durrës.
27. Rindërtimi i Shkollës së Mesme të Bashkuar "Ismet Nanushi" në Sukth.

28. Rikonstruksioni i Spitalit të ri të fëmijëve në Durrës.
29. Rikonstruksioni total i Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Dhosi Liperi” në Njësinë Administrative Sukth.
30. Rindërtimi total i shkollës Cikli i Ulët dhe kopshtit në Perlat, Nj. Adm. Sukth.
31. Qendër e re multifunktionale në shkollën “Jan Kukuzeli”, e cila do të funksionojë si sallë shfaqjesh teatrore, koncerte apo aktivitete të ndryshme në shërbim të nxënësve por edhe të komunitetit.
32. Rikonstruksioni i trotuarit prej 300 m² në rrugën “Fetah Bllaca”.
33. Mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve “Jahja Ballhysa”, “Neki Libohova”, “Abaz Çelkupa”, “Stefan Kaçulini”, “Mikëpritja Durrsake”, “Lazer Murati”, “Asti Gogoli”, “Bajram Tusha”, “Bulevardi Epidamn” etj.
34. Rehabilitimi i hapësirave të gjelbra dhe pastrimi i mbetjeve në lagjen nr. 3, pranë Shkollës së Muzikës.
35. Pastrimi i mbeturinave dhe i kanaleve në zonën e Spitallës në lagjen nr. 15.
36. Sistemimi i rrugëve dhe i ndriçimit në zonën turistike të Shkëmbit të Kavajës.
37. Pastrimi dhe dezinfektimi i rrotondës së Shkallnurit deri tek spitali i kockave.
38. Rikonstruksioni i shkollës për fëmijët me aftësi të kufizuara në qytetin e Durrësit.
39. Ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare “Myslim Hida” si dhe i kopshtit në fshatin Arapaj.
40. Ndërtimi i ujësjellësit të ri për Durrësin, i cili do të sjellë 3-fishin e sasisë së ujit që sillet më parë.
41. Rehabilitimi i kanalit të ujërave të larta për të parandaluar përmbytjet në disa lagje të qytetit të Durrësit.
42. Rikonstruksioni i rrugës “Gjon Buzuku”, e cila lidh plazhin me zonën e Shkozetit.
43. Rikonstruksioni i hapësirave midis pallateve në rrugën “Fatmir Haxhihyseni” lgj. Nr. 14 në Shkozet.
44. Asfaltimi i rrugës nga Kryqëzimi i Ariut deri në Perlat, Nj. Adm. Sukth.
45. Rikonstruksioni i shkollës “Artan Zeka” në fshatin Qerret, Nj. Adm. Katund i Ri.
46. Pastrimi dhe sistemimi i kanaleve vaditëse në fshatrat Kameronas, Radë dhe Borç, Nj. Adm. Manëz.

Premtime pjesërisht të arritura (në proces)

1. Vijon puna për rikonstruksionin e tre rrugëve, “Nikolla Tupe”, “Tefta Tashko” dhe rruga e Lamëve, me një gjatësi totale prej 1881 metra.
2. Vazhdon puna për rikonstruksionin total të çerdhes nr. 3, si dhe për shkollën “Eftali Koçi”.
3. Viojnë punimet për rindërtimin total të kopshtit “Met Hasa”.
4. Vazhdon puna për sistemimin e terrenit ku do të ndërtohet një lagje e re në Ishëm. Në këtë lagje do të ndërtohen 44 banesa, muzeu “Ibrahim Kodra” dhe një bibliotekë.
5. Viojnë punimet për riparimin e ambienteve të përbashkëta të pallateve të dëmtuara me shkallë dëmi DS1-DS2-DS3, në zonën e Shkozetit.
6. Vazhdon puna në lagjen e re në zonën e Spitallës, ku do të ketë 996 apartamente me standarte të larta.

7. Vazhdojnë punimet për përmirësimin e furnizimit me ujë të Sukthit, Ishmit dhe Katundit të Ri. Me përfundimin e punimeve banorët e këtyre zonave do të furnizohen me ujë 24 orë.
8. Po shkon drejt fundit puna për Ekoparkun e Madh të Durrësit në Porto Romano.
9. Vijon puna për ndërtimin e banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti në Njësinë Administrative të Sukthit.
10. Vazhdojnë punimet për ndërtimin e 280 shtëpive të dëmtuara nga tërmeti në Njësinë Administrative Manëz.

Burimi: <https://www.facebook.com/durres.gov.al>